


1021  
26-04-2024



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË  
SHTETIT**



**RADIO TELEVISIONI  
SHQIPTAR (RTSH)**


## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

Tiranë më, 26.04. 2024



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 694 Prot. Datë 26.04.2024



**RADIO TELEVISIONI  
SHQIPTAR (RTSH)**

Nr. 1021 Prot. Datë 26.04.2024

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

E lidhur sot, më datë 26.04.2024, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

**1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** (në vijim **AUTORITETI**), përfaqësuar nga znj. Gentiana Sula, Kryetarja e Autoritetit,

dhe

**2. Radio Televizioni Shqiptar** – person juridik publik, me NUIS J61904073Ë i krijuar me ligj të veçantë, ligji nr.97, datë 04.03.2013 “Për Mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin nr.98/2016 “Për miratimin e Statutit të RTSH” me seli në Tiranë, Rruga “Ismail Qemali” Nr.11, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **z.Alfred Peza**.

Palët janë marrë vesh se, për të realizuar qëllimin e përbashkët, do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje të shprehura më poshtë.

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e historisë dhe të ngjarjeve historike, të hedhura në kronika, reportazhe, filma, dokumentarë dhe mjete mbështetëse, për të kontribuar në nxjerrjen e së vërtetës dhe në njohjen e së shkuarës, nëpërmjet hapësirave e mundësive për ballafaqim me dosjet, dokumentet dhe historitë e komunizmit, në mënyrë që të edukohen brezat e rinj dhe të zhvillohet dialog i shëndetshëm shoqëror, në emër të një të ardhmeje më të mirë.

## Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimit dhe studimit të dokumenteve e të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit të periudhës 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991, të organeve të diktaturës komuniste dhe materialeve filmike, fizike dhe mbështetëse të prodhuara nga Radio Televizioni Publik Shqiptar.

Bashkëpunimi në fushën e materialeve fizike dhe digjitale me vlerë dokumentare, arkivave të filmit artistik dhe atij dokumentar, rubrikave mediatike, dëshmime gojore dhe të shkruara, botimeve, etj., mbi kujtesën kolektive dhe ndërgjegjësimin për të shkuarën, që hedhin dritë në krimet dhe pasojat e diktaturës së proletariatit në Shqipëri dhe periudhën kur ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit.

## Neni 3 Baza ligjore

Kjo Marrëveshje lidhet bazuar në Ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, ligjin nr. 9380 dt. 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, ligjin nr. 9154/2003, “Për arkivat”; Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016 “Për miratimin e Statutit të RTSH”, VKM nr. 93, datë 27.02.2019, “Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”; Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 12.02.2024, Rregulloren “Për dhënien në shfrytëzim të Materialeve arkivore ‘Mbi sistemin tarifor të shërbimeve që ofron RTSH për palët e treta’ të Drejtorisë Arkivor.

## Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Në përmbushje të kësaj marrëveshjeje, **AUTORITETI** dhe **RTSH** kanë të drejta dhe detyrime, dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të misioneve, si më poshtë:

- a. grumbullimin e të dhënave, dokumenteve dhe dëshmime për njohjen e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- b. grumbullimin e të dhënave dhe dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit, shkëmbime dhe hartime të programeve të përbashkëta për të bërë të mundur shfrytëzimin e një pjese të arkivave të RTSH-së dhe TVSH-së, për periudhën '44-'91, data dhe ngjarje që do të diktohen nga Autoriteti dhe partnerët e tij, të cilat janë në formate jo-digjitale;
- c. grumbullimin e të dhënave dhe dokumentacionit arkivor të lidhur me filmat artistikë dhe dokumentarë të Radio Televizionit Publik Shqiptar, reportazhet, kronikat, albumet

- fotografike, materialet e tjera mbështetëse, të ripunuara, foto, etj., që hedhin dritë mbi mënyrën e realizimit të produktit të miratuar nga pushteti i kohës;
- d. të bashkërendojnë punën për kryerjen e studimeve shkencore për rolin dhe funksionin e ish-Sigurimit në shtet dhe në shoqëri, si dhe për format e ndryshme të shfaqjes dhe ekzistencës së opozitës dhe kryengritjes ndaj regjimit komunist, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimitarisë së ish-Sigurimit të Shtetit;
  - e. shkëmbimin e vazhdueshëm të materialeve shkencore dhe informative të prodhuara në formë digjitale, me qëllim promovimin e vlerave historike dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me interesat e palëve dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi;
  - f. të marrin pjesë në takime të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i kësaj marrëveshjeje;
  - g. të bashkëpunojnë për të kryer mediatizimin e aktiviteteve përkujtimore apo edukative që organizon Autoriteti si: “dosja e hapur”, “gryqet e inskenuara”, apo pjesë teatrale, etj.;
  - h. të bëjnë të disponueshme, kundrejt kërkesave, dokumente dhe materiale arkivore, sipas arkivave të secilit institucion (palë në marrëveshje), që i përkasin periudhës së komunizmit dhe pasojave të tij, me fokus veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit dhe Radio Televizionit Publik Shqiptar dhe që i nevojiten secilës palë, në funksion të veprimitarisë së punës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat;
  - i. të bashkërendojnë punën për edukimin qytetar, nëpërmjet garantimit të mundësive për shqyrtimin e dokumenteve të organeve të diktaturës komuniste, duke përfshirë dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Radio Televizionit Publik Shqiptar të asaj periudhe (si dhe dëshmi, reportazhe, elementë të mëvonshëm, që i shërbejnë zbardhjes së të shkuarës); Krijimin e materialeve fizike: libra, fletëpalosje, broshura, etj., në letër dhe/apo digjitale: video, filma dokumentarë, etj., të cilët pasurojnë burimet për rishqyrtim të historisë dhe ridimensionim të ngjarjeve e figurave historike;
  - j. të krijojnë hapësirë televizive për diskutimin e temave mbi të shkuarën komuniste në programet televizive dhe radiofonike të RTSH-së. Përgatitje e programeve të përbashkëta për platformën “*Burime të hapura arsimore*”, në kanalin RTSH Edukim, me objekt “Të mësojmë të shkuarën”, në të cilat do të jenë të inskenuara ngjarje, personazhe apo vende të vuajtjes gjatë regjimit komunist, në formatet si: podcast, video të shkurtra, etj.; Përgatitja e një programi radiofonik për profile biografike të shquara, të cilët janë bërë të njohura kohët e fundit;
  - k. të bashkëpunojnë për të përgatitur dokumentarë me fokus fëmijët dhe të rinjtë, duke filluar me dokumentarin “50-vite Revolta e Spaçit|, ku kostot e skenaristit dhe historianëve i mbulon Autoriteti, ndërsa të produksionit televiziv RTSH-ja;
  - l. në kuadër të kujtesës historike, të bëhen përpjekje të përbashkëta për riorganizimin dhe risjelljen e programit të fëmijëve “TROÇ”, program i cili mund të konvertohet duke u fokusuar mbi kujtesën demokratike;
  - m. në kuadër të programit televiziv “Dritëhijet”, dhe “Dosje të hapura” Autoriteti dhe RTSH bashkëpunojnë mbi përzgjedhjen dhe trajtimin e dokumentacionit arkivor rreth figurave historike/kundërthëniet e familjareve, si dhe krijohet mundësi referimi në këtë program nga përfaqësues të Autoritetit;
  - n. të krijojnë mundësi për trajtimin dhe diskutimin e temave mbi të shkuarën komuniste e pasojat e saj në të sotmen edhe në kronikat televizive të lajmeve, që mund të hedhin dritë mbi ngjarje dhe personalitete historike të stigmatizuar;

- o. të shkëmbejnë plane vjetore të miratuara dhe të punojnë për projekte të përbashkëta hulumtues, studimorë, informues, të edukimit qytetar për demokraci dhe të drejta të njeriut, të mbështetur nga homologë e partnerë.

## **Neni 5**

### **Të drejtat e shfrytëzimit dhe pronësia intelektuale**

1- Të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të veprave audiovizuale të prodhuara nga RTSH-ja, si dhe të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të veprave në llojin e krijimeve të fjalës, të shprehura përmes shkrimeve letrare dhe publicistike, të veprave në llojin e krijimeve fotografike dhe të çdo krijimi tjetër, që shprehet nga çdo proces i ngjashëm me atë fotografik, të krijuara dhe të prodhuara në RTSH-ja, deri në datën 2 korrik 1991, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kohës (në vijim “Veprat”), janë në pronësi të vetme të RTSH-së.

2- Të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të dokumenteve dhe të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të organeve të diktaturës komuniste të periudhës kohore 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991 (në vijim “materialet dokumentare”), të cilat zotërohen nga AUTORITETI, në përputhje me legjislacionin shqiptar, janë në pronësi të vetme të AUTORITETIT.

3- RTSH-ja dhe AUTORITETI, në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, për kohëzgjatje me afat të pakufizuar të të drejtave të përcjelljes dhe komunikimit të publiku, përmes të gjitha formave të transmetimit që përdoren nga RTSH-ja, si dhe të transmetimit për publikun të Veprave audiovizuale me përmbajtjen e Veprave dhe të pjesëve të veçanta të tyre, të materialeve dokumentare dhe të pjesëve të veçanta të materialeve dokumentare, të cilat do të prodhohen në kuadër të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi.

4. Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dokumentacion arkivor, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës, e cila i ka në pronësi.

5. Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe planeve vjetore të shkëmbyera reciprokisht për periudhën e kohës gjatë së cilës zgjat marrëveshja.

## **Neni 6**

### **Kufizimet/Garancia**

1- Palët nënkuptojnë se, asnjë ndërhyrje në aktivitetet e secilës Palë nuk do të nënkuptohet si rezultat i këtij bashkëpunimi.

2- Të dyja palët nënkuptojnë se, ato nuk mund të përdorin imazhe ose përshkrime të dëshmimeve, intervistave, filmave, etj., në kuadër të projekteve të përbashkëta, për reklamim, as nuk mund t'i referohen Palës tjetër, ose këtij bashkëpunimi, në mënyrën që imponon miratimin ose sanksionimin nga ana e Palës tjetër ose të aktiviteve të tyre.

3- Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit bie dakord që vulat e RTSH-së, markat tregtare, logot, shenjat e shërbimit, emrat tregtarë, të cilët mund të jenë të pranishëm në faqen e internetit të Autoritetit, nuk do të keqpërdoren nga Autoriteti, në mënyrë të tillë që të nënkuptohet se aktivitetet e AIDSSH-së janë miratuar, sponsorizuar ose rekomanduar

2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.
3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet, që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis Palëve.

### Neni 11 Afati i marrëveshjes

1. Marrëveshja do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar, për një periudhë dy-vjeçare që nga momenti i nënshkrimit të saj, me të drejtë rinovimi dhe rishikimi. Kjo marrëveshje do të rinovohet në heshtje në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë pikë, në rast se palët përgjatë këtij afati nuk kanë dërguar njoftim drejtuar njëra-tjetrës sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

### Neni 12 Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi



1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera do të depozitohen në **Radio Televizionin Shqiptar (RTSH)**.

Për

**Autoritetin për Informimin mbi**

**Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**

Gentiana SULA

  
  
KRYETARË

Për

**Radio Televizionin Shqiptar**

Alfred PEZA

  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM